



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 93/2 prot.,

Datë 20.01.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Gentian Sadiku” PERSON FIZIK në procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar me mjete elektronike”, me Nr. REF-54973-12-23-2022, me objekt: “Blerje Uniforma për Policinë Bashkiake dhe Drejtorinë e Shërbimit të MZSH-së, Bashkia Fier, me 2 lote”, me fond limit 3.936.677 lekë pa TVSH, Loti I me Nr. REF-54978-12-23-2022, me objekt: “Blerje Uniforma për Policinë Bashkiake”, me fond limit të lotit 2.369.244 lekë pa TVSH zhvilluar më datë 09.01.2023, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier.

Ankimues: “Gentian Sadiku” PERSON FIZIK
Adresa: Rruga “Tom Plezha”, Pallati Milo, Nr. 7, Zona kadastrale 3866, Pasuria 298/211-N11, Yzberisht, Kashar, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Fier
Adresa: Lagja “Kastriot”, Rruga “Ramiz Aranitasi”, Nr.15, Fier.

Në datën 19.01.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është protokolluar ankesa me nr. 93 prot., e operatorit ekonomik “Gentian Sadiku” PERSON FIZIK për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar me mjete elektronike”, me Nr. REF-54973-12-23-2022, me objekt: “Blerje Uniforma për Policinë Bashkiake dhe Drejtorinë e Shërbimit të MZSH-së, Bashkia Fier, me 2 lote”, me fond limit 3.936.677 lekë pa TVSH, Loti me Nr. REF-54978-12-23-2022, me objekt: “Blerje Uniforma për Policinë Bashkiake”, me fond limit të lotit 2.369.244 lekë pa TVSH zhvilluar më datë 09.01.2023, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Gentian Sadiku” PERSON FIZIK.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:
b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “Gentian Sadiku” PERSON FIZIK kundërshton me anë të ankesës me nr. 93 prot., datë 19.01.2023.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyen e skualifikimit si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit:

“• Operatori ekonomik “GENTIAN SADIKU” PF me NUIS L42314005A
Bazuar në Kriteret e Përgjithshme të kualifikimit sipas Shtojcës 7 të DST, si dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit:

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.6. Operatorët Ekonomikë pjesëmarrës duhet të paraqesin mostrat (kampionet), per artikullin si me poshte, në ditën e hapjes së ofertave, në orën dhe vendin e caktuar në dokumentat e tenderit:

Uniforme e sherbimit dimeror stof leshi (1 xhaketë, 2 pantallona, 2 kapele)

Mostra e kërkuar duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë:

mostër “emri i artikullit”, numrin rendor sipas ofertës së paraqitur, objektin dhe datën e zhvillimit të tenderit, emrin e

ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik ofertues.

Mostra duhet të jenë në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të kërkuara.

Mostra do te dorezohet perpara komisionit, ne oren dhe daten e percaktuar per hapjen e ofertave, pranë Autoritetit

Kontraktor, Bashkia Fier, Drejtoria e KVO, Kati i IV-të, Lagja “Kastriot”, Rruga “Ramiz Aranitasi”, Fier.

Nga Operatoi ekonomik nuk u paraqitën mostrat sipas kërkesave të mësipërme duke përbërë shkak për skualifikim.”.

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 20.01.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiorent Zguro